



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 200, datë 25.3.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË
MIRDITË DHE KAMZË DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Mirditë dhe Kamzë, në masën 466 930 089 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Mirditë, në masën 102 720 089 (njëqind e dy milionë e shtatëqind e njëzet mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për:
 - i. rikonstruksionin dhe sistemin e ngrohjes së godinës nr.3 (3 kate), shkolla 9-vjeçare "Pashko Vasa", Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 45 969 907 (dyzet e pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatë) lekë pa TVSH;
 - ii. rikonstruksionin e kopshtit të fëmijëve (godina e vjetër), Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 23 544 114 (njëzet e tre milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë e njëqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH;
 - iii. rikonstruksionin e kopshtit të fëmijëve me aftësi ndryshe (ish-godina e SHIK-ut), Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 33 206 068 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

b) Bashkisë Kamzë, në masën 364 210 000 (treqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e dyqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH, për:

i. rikonstruksionin e gjimnazit "Isa Boletini", Bashkia Kamzë, në masën 292 810 000 (dyqind e nëntëdhjetë e dy milionë e tetëqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH;

ii. rikonstruksionin e kopshtit "Zall Mner", Bashkia Kamzë, në masën 71 400 000 (shtatëdhjetë e një milionë e katërqind mijë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkitë Mirditë dhe Kamzë, në masën 93 386 017 (nëntëdhjetë e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, detajohet, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi në masën 20 544 017 (njëzet milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 72 842 000 (shtatëdhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e bashkive Mirditë dhe Kamzë si njësi zbatuese për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Mirditë e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARREN ALMETAJ

NR.PROT. 1579/1
DATË 29-3-2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE MIRDITË E KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

